



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 75-të, të mbajtur më 14.10.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi me numër 12-719/1 i datës 03.02.2022, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm ndaj lëndës.

Denoncimi t'i përcillet Këshillit Inspektues të RMV-së për veprim kompetent.

Lënda me numër 12-719 të vitit 2022 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-719/1 të datës 03.02.2022 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga ///. Pretendimet e paraqitura në denoncim i referohen dyshimeve për kryerje joprofesionale dhe të pakujdesshme të funksionit të inspektimit personit zyrtarë ///, inspektori shtetëror i bujqësisë në Inspektoratin Shtetëror të Bujqësisë në ///. Denoncimi është plotësuar radhazi më 02.10.2022 dhe më 13.10.2022. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit janë vendosur fotografitë si dëshmi.

Nga mbikëqyrja në përmbajtjen e denoncimit dhe provave të dorëzuara , KSHPK-ja vlerësoi se lënda nuk elemente për veprim kompetent. Organi kompetent që është i autorizuar për të hetuar dyshimet është Këshilli Inspektues i RMV-së, për këtë arsye KSHPK-ja e konsideroi të nevojshme që denoncimin së bashku me provat t'ia përcjellë këtij organi.

Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:
Parashtruesi

Përgaditi: Mr D. D.
Miratoi:

N.B.

KOMISIONI SHTETËRORË

ПЃР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ
КРЈЕТАРЕ,
Biljana Ivanovska

